

DEKRET
Nr. 8724, datë 26.9.2014

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 126/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë sovrane dhe të zhdëmtimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, bankës Vseobecna Uverova Banka, a.s., Sllovaki dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, sh.a., për kundërgarancinë e bankës Vseobecna Uverova Banka, a.s., Sllovaki, për marrëveshjen e garancisë bankare ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., dhe bankës Vseobecna Uverova Banka, a.s., Sllovaki, dhe për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, sh.a.”.

Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 126/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë sovrane dhe të zhdëmtimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, bankës Vseobecna Uverova Banka, a.s., Sllovaki, dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, sh.a., për kundërgarancinë e bankës Vseobecna Uverova Banka, a.s., Sllovaki, për marrëveshjen e garancisë bankare ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., dhe bankës Vseobecna Uverova Banka, a.s., Sllovaki, dhe për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, sh.a.”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Bujar Nishani